



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT

OPŠTINA LIPLJAN

MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË /A	12.09.2024
REFERENCË	
PËR:	z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan
CC:	z. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës në Lipjan z. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës në Lipjan
NGA:	z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Lipjan
LËNDA:	Raport i punës – Muaji Gusht 01.08.2024-30.08.2024

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë muajit Gusht DKA ka realizuar punë dhe aktivitete të ndryshme brenda kompetencave të veta.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Më datë **10.08.2024** është bërë përgaditja e formularëve për ndryshime të personelit shkollor.

Është bërë furnizimi i shkollave me lëndë djegëse PELET gjatë muajit gusht:

- 1."Qerdhja" Lipjan,
- 2.Shfmu "Migjeni" Rufe i Ri,
3. Shfmu "Vezir Kolshi" Baicë,
4. Shfmu "Nezë Bujani" Bujan,
5. Shfmu "Ernest Koliqi" Babush i Muhagjerëve,
6. Shfmu "Haradin Bajrami" Magurë,
7. Shfmu "Ibrahim Banushi" Shalë,
8. Shfmu "Shtjefën Gjeçovi" Janjevë,
9. Shfmu "7 Marsi" Poturovc,
10. Shfmu "Kadri Beba" Ribar i Madhë,
11. Shfmu "Hasan Zyko Kamberi" Sllovi,
12. Shfmu "Ibrahim Krasniqi" Smallushë,
- 13.Shkolla " Vëllezërit Aksiq" Lipjan

Gjatë muajit Gusht janë kryer këto punë:

-Zotimin e mjeteve në të gjitha kategoritë si:

Mallra dhe Meditje, Komunali dhe

në nivelet:

-Administratë,

-Parafillor,

-Fillor dhe të

-Mesme

Është bërë hartimi i kërkesës së Buxhetit për vitin 2025 konform Qarkores Buxhetore 2025-2027. Nënaloqimi i mjeteve në të gjitha kategoritë dhe nivelet

Menagjimi dhe mbarëvajtja e kontratave të ndryshme me furnizimin dhe shërbimet e duhura konform nevojave të shkollave dhe departamentit.

Është kryer furnizimi i shkollave dhe qerdheve me material shkollor.

Është mbajtur takimi me datë 13.08.2024 në shkollën ‘Vëllezërit Frashëri’ në Lipjan, ku të rinjët prezantuan projektet e tyre inovative .

Të pranishëm në këtë ngjarje ishin Drejtori i shkollës, zyrtarja komunale e Arsimit, Shefja e UNICEF-it, dhe përfaqësues të Ipko Foundation.

Është bërë përmbyllja e Projektit “Zëri juaj”, i cili ka prezantuar paisje shkollore të qasshme për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Është bërë gjithashtu përmbyllja e projektit “Uji-një faktor i rëndësishëm”, projekt i cili ka prezantuar një sistem ujitje për mirëmbajtjen e shkollave me një paisje robotike.

Është mbajtur takimi i Komisionit Vlerësues në shkollën fillore Vëllezërit Frashëri, ku pjesëmarrës ka qenë edhe zyrtarja komunale në komision të projekteve PODIUM nga Ipko Foundation, e cila ka për qëllim fuqizimin e të rinjëve.

Në këtë garë kanë qenë 10- grupe, ku 4 prej tyre janë vlerësuar nga juria për të fituar grant në vlerë prej **500** euro, për implementimin e ideve të reja.

Ka përfunduar Renovimi i shkollës në:

Silovi “ Hasan Zyko Kamberi,

Shalë “Shaqir Hoxha” dhe “Ibrahim Banushi, dhe

Medvec “Fehmi Agani”.

Është intervenuar në Renovimin e banjove në shkollat:

Ismail Luma në Lipjan, dhe

“Katër Dëshmoret” në Krojmir.

Janë furnizuar me inventar shkollor (tabela, banka dhe karriga), shkollat:

Topliqan “Vëllezërit Domaneku”,,

Silovi “Hasan Zyko Kamberi”,

Rufc “Migjeni” dhe

Baicë “Vezir Kolshi”.

Me 31.08.2024 është mbajtur testi i maturës afati i dytë, DKA ka bërë me kohë përgaditjet për organizimin dhe mbajtjen e testit.

Në afatin e dytë gjithsej kanë qenë **2** qendra të testimit, në të cilat kanë marrë pjesë **250** nxënës.

Pjesëmarrja në takim për hartimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal, ku gjithsej janë mbajtur 3 takime.

Pranimi i kërkesave nga arkiva, komunikimi me drejtorët e shkollave për hartimin e statistikave për nevoja të drejtorëve.

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe atë:

- Formular për ndryshime-kthimi nga lehonja, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit, shtimi i përvojës,
- Formular për largim-skadim kontrate, pensionimi,
- Formular për punëtor të rinjë,
- Të ndryshme-ndërrimi i xhirollogarisë.

Nënalokimi i mjeteve në të gjitha kategoritë:

- a). Paga&meditje
- b). Mallra&komunali
- c). Komunali

Zotimet në kategorinë mallra & sherbime dhe komunali.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme (kërkesa për punësim, pushim mjekësor, pushim lehonie etj).

REKOMANDIMET

- Angazhimi i drejtorëve të shkollave për një organizim sa më të mirë të procesit edukativo-arsimor dhe
- Angazhimi i psikologeve në trajtimin e temave me rëndësi për nxënësit në të gjitha shkollat e Komunës.

ÇËSHTJE TJERA

Të gjitha punët e realizuara janë cekur në raport dhe nuk ka ndonjë çështje tjetër për të elaboruar. DKA do të punoj vazhdimisht për krijimin e kushteve sa më të mira në të gjitha shkollat e Komunës sonë, duke menduar gjithmonë më të mirën për të gjithë nxënësit.